



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

FLETINFORMACION

PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes:

KSC-BC-2020-07/KSC-CA-2022-01/KSC-SC-2023-01

Prokurori i Specializuar kundër:



Hysni Gucatit



Nasim Haradinajt

Faza e çështjes:

KRYERJA E DËNIMIT

TË AKUZUARIT/AKUZAT

Hysni Gucati

Datëlindja: 30/03/1967

Funksionet gjatë periudhës së mbuluar prej aktakuzës:

- Kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Nasim Haradinaj

Datëlindja: 21/05/1963

Funksionet gjatë periudhës së mbuluar prej aktakuzës:

- Nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Përshkrimi i akuzave

Sipas aktakuzës, së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, në tre konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme, Gucati dhe Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm). Gucati dhe Haradinaj gjithashtu bënë akuza dhe komente nënçmuese kundër dëshmitarëve (të mundshëm) dhe në mënyrë të përsëritur shprehen synimin e tyre për të dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara.

Format e përgjegjësisë

Kryerje e drejtpërdrejtë/Tentim për kryerjen e veprave penale
Bashkëkryerje/Marrëveshje për kryerjen e veprave penale
Nxitje
Ndihmë

Akuzat

1. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes kanosjes serioze (vepra penale kundër rendit publik)
2. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes veprimit të përbashkët në grup (vepra penale kundër rendit publik)
3. Frikësim gjatë procedurave penale (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)
4. Hakmarrje (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)
5. Shkelje e fshehtësisë së procedurës, me anë të zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)
6. Shkelje të fshehtësisë së procedurës, me anë të zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

DËNIMET

Aktgjykimi i Trupit Gjyqes, 18 maj 2022

Trupi Gjyqes shpalli të dy të akuzuarit fajtorë për pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 të aktakuzës ndërsa i shpalli të pafajshëm për hakmarrje (pika 4). Sa i përket formave specifike të përgjegjësisë, Gucati dhe Haradinaj u shpallën fajtorë si:

- bashkëkryerës për pikat 1, 3, 5 dhe 6
- kryerës të drejtpërdrejtë për pikën 2

Dënimi: katër vjet e gjysmë burgim dhe gjobë prej 100 eurosh për secilin

Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023

Paneli i Apelit la në fuqi verdiktet e fajësisë së Gucatit dhe Haradinajt për pikat 1, 3, 5 dhe 6 ndërsa i shpalli të pafajshëm për pikën 2.

Dënimi: katër vjet e tre muaj burgim dhe gjobë prej 100 eurosh

KRONOLOGJIA

Pas arrestimit të tyre nga Prokurori i Specializuar, Gucati dhe Haradinaj u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, më 25 dhe 26 shtator 2020.

Më 29 shtator 2020, ata u paraqiten si të dyshuar para gjykatësit të vetëm të DHSK-së, Nikola Giju, cili më 11 dhjetor 2020 konfirmoi aktakuzën kundër dy të akuzuarve.

Seancat e paraqitjes së parë të Gucatit dhe Haradinajt u mbajtën më 18 dhjetor 2020 para gjykatësit të procedurës paraprake. Gucati u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës kurse Haradinaj vendosi të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë brenda 30 ditësh. Në paraqitjen e mëtejshme, më 8 janar 2021, Haradinaj nuk u vetëdeklarua në lidhje me fajësinë ose pafajësinë. Bazuar në rregullën 92(2)(f) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake bëri deklarinimin në emër të të akuzuarit se është i pafajshëm.

Më 16 korrik gjykatësi i procedurës paraprake ia kaloi dosjen e çështjes trupit gjykues II. Gjykimi filloi më 7 tetor 2021 dhe zgjati deri më 17 mars 2022. Aktgjykimi u shpall më 18 maj 2022: Trupi Gjykues shpalli të dy të akuzuarit fajtorë dhe dënoi secilin me nga katër vjet e gjysmë burgim dhe me gjobë prej 100 eurosh. Gucati dhe Haradinaj apealuan aktgjykimin dhe Kryetarja e DHSK-së caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar apelet. ZPS-ja nuk apeloj aktgjykimin. Aktgjykimi i apelit u shpall më 2 shkurt 2023: shumica e Panelit të Apelit uli dënimin në katër vjet e tre muaj burgim dhe la në fuqi dënimin me gjobë prej 100 eurosh për secilin.

Në maj 2023, Haradinaj dhe Gucati dorëzuan kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në përputhje me nenin 48(6)-(8) të Ligjit dhe rregullën 193 të Rregullores. Më 18 shtator 2023, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesat.

Pas modifikimit të dënimeve të tyre nga Kryetarja e DHSK-së, Trendaflova, Gucati dhe Haradinaj u liruan me kusht më 17 tetor dhe 14 dhjetor 2023, respektivisht.

STATISTIKAT E ÇËSHTJES

Kohëzgjatja e procedurës paraprake	12 muaj 12 ditë
Numri i ditëve të gjykimin në sallën e gjyqit	32
Numri i dëshmitarëve gjatë gjykimin	14 (4 ZPS; 6 Gucati; 4 Haradinaj)
Numri i dëshmive me shkrim të dëshmitarëve	18 (12 Mbrojtja e Gucatit; 6 Mbrojtja e Haradinajt)
Kohëzgjatja e gjithsejtë në Gjykatën Themelore	19 muaj 24 ditë
Kohëzgjatja e çështjes në apel	7 muaj 16 ditë
Kohëzgjatja në DHSK	Gucati: 3 vite 22 ditë; Haradinaj: 3 vite, 2 muaj dhe 19 ditë

TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatës Nikola Giju

TRUPI GJYKUES II



Gjykatës Çarls Smith III
(kryesues)



Gjykatës Kristof Barte



Gjykatës Genël Metro



Gjykatës Fergal Gejnor
(gjykatës rezervë)

PANELI I GJYKATËS SË APELIT



Gjykatëse Mishelë Pikar
(kryesuese)



Gjykatës Kai Ambos



Gjykatëse Nina Jorgensen

PANELI I GJYKATËS SUPREME



Gjykatëse Ekaterina
Trendafilova (kryesuese)



Gjykatëse Kristinë van
den Vijngart



Gjykatës Daniel Fransen

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Valeria Boliqi



Metju Halling



Xhejms Paqe

EKIPET E MBROJTJES (MBROJTËSI KRYESUES)



Xhonëthën Elistan Ris
(për H. Guçatin)



Tobi Kadman (për N.
Haradinajn)

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN

Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj
për të skanuar kodet e mëposhtme:



Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës




Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSK-së



Profili X i DSK-së



Profili Instagram i DSK-së



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN